



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:009934  
Datë: 19.10.2018  
Numri i dokumentit: 00149833

P.nr. 1085/2016

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit S.K., për shkak të veprës penale, **Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nënparag. 1.4 të KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 1636/2016, të datës 25.08.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 16.10.2018, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa më datë 18.10.2018, përpiloi këtë:

**AKTGJYKIM**

*I akuzuari S.K., nga babai H. dhe nëna R., e lindur V., i lindur më datë ... në fsh. ..., K. e ..., ku edhe jeton, i pamartuar, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij.*

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse, me datë 30.08.2016, rreth orës 00:30 min, në rr. “A.Presheva” në Gjilan, në banesën ku banonin, e ka lënduar lehtë të dëmtuarën A.Sh. nga ..., për shkak se ajo nuk donte të rrinte me te, sepse nuk kishin me çka të jetonin, në atë mënyrë që në fillim e ka goditur me grushta nëpër pjesë të ndryshme të trupit dhe më pas, me një kabllo, të cilën ia ka vendosur në fyt dhe e ka shtrënguar, duke I thënë: “kam me të furrë, nuk guxon me dale jashtë”, me ç’rast, të njëjtës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjeve të indeve të buta të parakrahut dhe krahut të djathtë, si dhe qafës dhe regjionit umoral të majtë, me pasoja të përkohshme për shëndetin,

-me çka ka kryer veprën penale, **Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 parag.1 nënparag. 1.4 te KPRK-së**, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 51, 73, 114 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i shqipton në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,46,73,114,të KPRK-së, dhe nenit 365, dhe 453 të KPPRK-së.

## **E G J Y K O N DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarin **S.K.**, me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (një) viti**, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe **paushallin gjyqësor** në lartësi prej **15 (pesëmbëdhjetë) €**, te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, **udhëzohet në kontest juridiko-civil**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur propozim akuzë PP.nr. 1636/2016, të datës 26.08.2016, kundër të akuzuarit S.K., për shkak të veprës penale, Lendim i lehte trupor nga neni 188 parag. 1 nënparag. 1.4 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Meqenëse i akuzuari e pranoi fajsinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, pranim i cili është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, i njoftuar nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajsisë, nuk pati nevojë që të administrohen prova të tjera.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari S.K. e ka kryer veprën penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 parag. 1 nënparag. 1.4 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, hera e parë që është ndeshur me ligjin ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 1085/16, më datë 18.10.2018**

Gjykatësja e vetme gjyqësore,  
Luljete Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtes. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:009934  
Datë: 19.10.2018  
Numri i dokumentit: 00149833